



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor  
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2181  
Datë: 1/9/2016

Në bazë të nenit 48 dhe në lidhje me nenin 111, 116 dhe 118 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 01.9.2016, mori këtë

**VENDIM**

**për kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve master për vitin akademik 2016/2017**

- I. Studentët e Universitetit të Prishtinës mund të regjistrojnë vitin vijues të studimeve master për vitin akademik 2016/17 po që se arrijnë kalueshmërinë e 50 % të provimeve nga viti paraprak.
- II. Studentët nuk mund ti nënshtrohen provimeve të vitit të dytë pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të parë.
- III. Provimet për studimet master mbahen gjatë afatit të provimeve. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit).
- IV. Pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve master, studentit do t'i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).
- V. Studenti mund të kërkojë një herë nga dekan i njësisë akademike për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj të tjerë.
- VI. Programet e studimeve master përfundojnë me punimin e tezës për master në pajtim me programet e studimeve.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit dhe vlenë për regjistrimin e vitit akademik 2016/2017.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së
2. Dekanëve të fakulteteve
3. Zyrtarit ligjor të UP-së
4. Sekretarëve të fakulteteve



Prof. Dr. Marjan Dema